



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **HISTORI**

Lënda: HISTORIA E MESJETËS

<i>Pedagogu:</i>	Prof. Asoc. dr. Ermal BAZE
<i>Ngarkesa:</i>	6 ETCS (15 javë: 3 leksione dhe 1 seminar në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	Bazë
<i>Viti/semestri:</i>	I/II

Përshkrimi: Historia e Mesjetës: disiplinë që studion nga pikëpamja historike periudhën midis shekujve V- XV dhe fokusohet më tepër në evoluimin e qytetërimit në kontinentin tonë. Nocioni « Mesjetë », përdoret kryesisht në Europë dhe është i lidhur kryesisht me studimin e shoqërisë mesjetare europiane. Historia e Mesjetës studion zhvillimet politike, sociale, ekonomike, fetare e kulturore të Europës, në epokën e ndërmjetme, midis fundit të Antikitetit dhe fillimit të kohëve të hershme moderne.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje. Objekti i studimit të historisë së Mesjetës. Mesjeta si problem historik. Kufijtë kronologjikë të saj. Periodizimi i Historisë së Mesjetës. Burimet për Mesjetën. Rëndësia e Mesjetës në historinë e njerëzimit.
2. Shembja e Perandorisë Romake të Perëndimit dhe krijimi i mbretërive romako – gjermanike. Fiset gjermanike. Kontaktet midis romakëve dhe gjermanëve. Pushtimet gjermanike. Fundi i Perandorisë Romake të Perëndimit dhe krijimi i mbretërive romako – gjermanike. Themelimi dhe veprimtaria politike e dinastisë franke merovinge.
3. Europa Karoline. Themelimi i dinastisë franke karoline. Pushtimet e Karlit të Madh dhe kurorëzimi i tij si perandor në Romë. Organizimi i shtetit karoling. Rilindja intelektuale karoline. Vlerësimi i veprës së Karlit të Madh. Ndarja dhe shpërbërja e Perandorisë Karoline (Traktati i Verdunit). Dyndjet e fundit në Europë (vikingët, hungarezët, saraçenët) në shekujt IX – X.
4. Ekonomia dhe shoqëria në Mesjetën e hershme: Kriza demografike. Fillimet e feudalizmit dhe të shoqërisë feudale. Origjina e feudalizmit. Hierarkia feudale. Kisha dhe feudalizmi. Sistemi i feudeve. Administrimi i pronës feudale Agrikultura, funksioni kryesor i pronës feudale. Metodrat dhe teknologjia bujqësore në Mesjetë.
5. Kalorësia në shoqërinë feudale. Heraldika e kalorësisë. Kështjellat – simbol e epokës mesjetare. Disa aspekte argëtuese të jetës së fisnikërisë. Rënia e rolit të kalorësisë.
6. Zhvillimet politike në Lindje dhe ekspansioni arab. Dyndjet sllave dhe themelimi i formacioneve të tyre politike në Europë. Themelimi i shtetit të hershëm mesjetar rus. Procesi i kristianizimit në Principatën e Kievit. Kalifati arab dhe pushtimet e tij në Mesdheun perëndimor. Shteti mongol dhe inkursionet e tyre në Europën Lindore
7. Europa dhe synimet e saj kundrejt botës myslimane. Invazionet normane në Itali dhe Siçili. Qytetërimi mysliman në Spanjë. Faza e parë e Rekonkustës në Spanjë. Origjina, zhvillimi dhe rrjedhojat e kryqëzatave. Disa mendime dhe vlerësime rreth kryqëzatave.
8. Ekonomia dhe shoqëria në Mesjetën e mesme. Rigjallërimi i tregtisë dhe i rrugëve tregtare. Panairët si qendra të tregtisë europiane. Lidhja e Hanzës. Lindja dhe organizimi i gildeve tregtare dhe zejtare. Rilindja e jetës urbane. Faktorët që ndikuan në ngritjen dhe zhvillimin e qyteteve. Pavarësia politike e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



qyteteve mesjetare dhe lindja e institucionit të komunës. Modeli i qytetit mesjetar. Rigjallërimi i ekonomisë monetare. Lindja e bankave dhe e sistemit të kredive.

9. Zhvillimet politike në Europë në shekujt XI – XIII. Perandoria Skandinave nën Knutin e Madh. Mbretëria angleze gjatë William Pushtuesit dhe pasardhësve të tij – veprimtaria politike e dinastisë plantagenete (Karta e Madhe e lirive dhe lindja e parlamentit anglez). Mbretëria Franceze në kohën e dinastisë kapetinge. Perandoria e shenjtë Romake Gjermane dhe dinstia e Hohenshtaufenëve. Peizazhi politik në territoret italiane (Mbretëria e Dy Siçilive, Papatit dhe komunat tregtare veriore). Rekonkuista dhe repoblacioni në Spanjë (faza e dytë). Principatat sllave dhe Rusia në periudhën e dytë të Mesjetës.
10. Krishterimi dhe Kisha Katolike në periudhën midis viteve 500 – 1300. Papa Gregori i Madh dhe Papatit në Mesjetën e Hershme (600 – 1050). Aktiviteti misionar i Kishës, ruajtja dhe transmetimi i kulturës klasike prej saj. Monakizmi Benediktin dhe reformat e tjera monastike. Reforma klyniste. Reforma Papale e shekullit XI. Rivaliteti midis kishës dhe shtetit: Revolucioni Gregorian dhe Lufta për Investiturë. Apogjeu i pushtetit papal në kohën e Inocentit III. Administrimi dhe organizimi i Kishës Katolike. Herezia dhe Inkuizicioni. Themelimi dhe veprimtaria e urdhërave domenikanë dhe françeskanë.
11. Mendimi dhe Arti Mesjetar 500 – 1300. Rritja e rëndësisë së studimit dhe skolasticizmi. Kontributi i Abelardit dhe i Tomas Akuinit. Rënia e Skolasticizmit. Shkenca në Mesjetë dhe përparimet në fushën e mjekësisë. Lindja dhe zhvillimi i universiteteve. Sistemi i Bolonjës dhe i Parisit. Letërsia latine dhe krijimtaria popullore. Veprimtaria letrare e Dante Aligerit.
12. Ekonomia dhe shoqëria në Mesjetën e Vonë 1300 – 1500. Kriza demografike dhe “Vdekja e Zezë” (1346 – 1353). Revoltat fshatare në Francë dhe në Angli. Zhvillimi i ekonomisë dhe i teknologjisë navale. Fillimet e zbulimeve gjeografike. Zbulimet më të rëndësishme gjeografike të shekullit XV.
13. Kisha Katolike dhe Papatit në Mesjetën e Vonë. Skizma e Kishës Katolike në Perëndim. Papatit i Avinjonit. Lëvizja Konciliariste dhe kapërcimi i skizmës. Koncili i Konstancës.
14. Zhvillimet politike në Europë përgjatë Mesjetës së Vonë 1300 – 1500.
15. Humanizmi dhe Rilindja e hershme Europiane 1300 - 1500. Origjina e Rilindjes europiane. Humanizmi dhe rilindja e kulturës klasike. Petrarka, babai i humanizmit, Bokaço dhe Dekameroni. Disa vlerësime rreth Humanizmit. Piktura, Skulptura dhe Arkitektura e viteve 1400. Përhapja e humanizmit dhe rilindjes në Europën Veriore.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Detyrim frekuentimi në: 70% të seminareve	
- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Testi I: në javën e 6-të	10% e notës
- Testi II: në javën e 10-të	10% e notës
- Detyra e kursitose ese: rreth 5 faqe format A4, TNR, 12, hapësira 1.5):	20% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	50% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

1. J. Goff, *Qytetetërimi i Perëndimit Mesjetar*, Tiranë: Toena, 1997.
2. E. Baze, *Historia e Shoqërisë Europiane në Mesjetë 500 - 1500*, Tiranë: Onufri, 2007.
3. E. Baze, *Historia e Mesjetës së Hershme Europiane 500 – 1000*, Tiranë: Albas, 2016.
4. Thoma Murzaku, Abaz Mullai, Gëzim Sala, *Historia e Mesjetës* (shek. V – XV), Tiranë: Onufri, 2016.

Literatura plotësuese:

1. J. Goff. *Mesjeta në zanafillat e Identitetit European*, Tiranë: SHLK, 2002.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I HISTORISE



2. J. P. Geary, *Miti i Kombeve (Origjina Mesjetare e Europës)*, Tiranë: OMBRA GVG, 2009.
3. R. S. Lopez, *Lindja e Europës*, Tiranë: Dituria, 2012.
4. H. Pirenne, *Muhamedi dhe Karli i Madh*, Tiranë: "55", 2006
5. *The New Cambridge Medieval History* (volume I – VII), 500 – 1500, Cambridge: Cambridge University Press, 2005 – 2009.
6. Kolana e shtëpisë botuese Dituria: G. Potesta & G. Vian, *Historia e Krishterimit*, Tiranë: Dituria, 2012. P. Milza, *Historia e Italisë*, Tiranë: Dituria, 2012. G. Duby, *Historia e Francës*, Tiranë: Dituria 2012. F. De Garcia & J. Gonzalez, *Historia e Spanjës*, Tiranë: 2012. Th. Maissen, *Historia e Zvicrës*, Tiranë: 2013. J. Anisimov, *Historia e Rusisë*, Tiranë: Dituria, 2014. Ph. Chassaingne, *Historia e Anglisë*, Tiranë: Dituria 2015. A. Niederstätter, *Historia e Austrisë*, Tiranë: 2015.